




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <i>D-P</i>	Br. Prot. <i>01-4550/11</i>
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum <i>19. 11. 2011</i>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datën 19.10.2011, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. protokolli: AKK – 03-3335 / 11, i trajtuar për konflikt interesi për zyrtarin, Ztr. Muhamet MUSTAFA – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.***
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur të paraqiten rrethana të ngjashme.***

**A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt Interesi, me nr. protokolli AKK-03-3335/11, është vërtetuar se kanë ekzistuar prova të mjaftueshme që kanë dëshmuar gjendjen e konflikti të interesit për zyrtarin e lartë, prandaj të lartpërmendurit i është bërë shkresa e parë njoftuese me datën 28.09.2011 me të cilën ai është njoftuar për ekzistimin e situatës konflikt interesi dhe njëkohësisht zyrtarit i është mundësuar takimi me zyrtarët e Agjencisë për të sqaruar situatën si

dhe për tu njoftuar për veprimet të cilat duhet t'i ndërmer për ta shmangur situatën në të cilën është gjendur.

Me datën 10.10.2011 me zyrtarin e lartë të përfshirë në këtë rast, është mbajtur një takim që ndryshe quhet "njoftimi me faktet që i posedon Agjencia" (neni 18 pika 3, Ligji nr.04/L-051) në të cilin zakonisht zyrtari njoftohet detalisht pse ndodhet në situatë konflikt interesi dhe po ashtu njoftohet me afatet ligjore, dhe me procedurat që duhet t'i ndjek për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Në po të njejtin takim zyrtari i lartë, Muhamet Mustafa na ka ofruar dokumentin e kërkuar nga Agjencia, me situatë të shmangur të konfliktit të interesit. D.m.th. zyrtari që në momentin e marrjes së shkresës së parë njoftuese nga Agjencia (28.09.2011) ka nisur veprimet e nevojshme për të shmangur situatën konflikt interesi.


Dokumenti i ofruar ka qenë informatë zyrtare për biznesin, (DP-03/3948) e lëshuar me datën 11.10.2011 nga Agjensioni për Regjistrimin e Bisneseve në Kosovë, në të cilin shihet se Ztr. Muhamet Mustafa, ashtu siç është kërkuar nga ai, konform nenit 14. pika 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ka bërë bartjen e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes në persona tjetër (të besuar), dhe se i njejt nuk ka më pozitë menaxhuese në këtë biznes.

Prandaj ***në bazë të Ligjit Nr.04/L-051***, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ***neni 18, pika 4 dhe 12***, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nxjerr këtë vendim me të cilin vendoset si në dispozitiv.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Shefit të Divizionit për P.K.I.
- Zyrtarit përgjegjës në AKK
- Zyrtarit Muhamet Mustafa  
(Deputet në Kuvendin e Kosovës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

  
/ Hasan Preteni /  
